

# FAVORIT 44010 VI

Udhëzimet për përdorim  
Инструкция по  
эксплуатации

Enëlarëse  
Посудомоечная  
машина

Faleminderit që keni zgjedhur një nga produktet tona me cilësi të lartë.

Për të siguruar efektshmëri optimale dhe të vazhdueshme me pajisjen tuaj shtëpiake ju lutemi lexoni me kujdes këtë manual udhëzimi. Ai do t'ju mundësojë që të kontrolloni të gjitha proceset në mënyrë të përkryer dhe të efektshme. Për t'iu referuar këtij manuali sa herë që keni nevojë, ne ju rekomandojmë ta mbani atë në një vend të sigurt. Dhe ju lutemi kalojeni atë te çdo pronar i ardhshëm i pajisjes shtëpiake.

Ne ju urojmë shumë kënaqësi me pajisjen tuaj të re shtëpiake.

## Përmbajtja

Udhëzimet e funksionimit	3	Aktivizimi/çaktivizimi i funksionit Multitab	17
<b>Të dhëna për sigurinë</b>	<b>3</b>	<b>Programet e larjes</b>	<b>18</b>
Përdorimi i saktë	3	<b>Përzgjedhja dhe startimi I një programi larës</b>	<b>19</b>
Siguria e përgjithshme	3	<b>Zbrazja e enëlarëses</b>	<b>20</b>
Siguria e fëmijëve	4	<b>Kujdesi dhe pastrimi</b>	<b>20</b>
Instalimi	4	Pastrimi i filtrave	20
<b>Përshkrim i produktit</b>	<b>5</b>	Pastrimi i krahëve spërkatës	21
<b>Paneli i kontrollit</b>	<b>6</b>	Pastrimi i jashtëm	21
Modaliteti i përzgjedhjes	7	Pastrimi i brendshëm	21
Sinjalet akustike	7	Kohë të gjata mos-përdorimi	22
<b>Përdorimi i parë</b>	<b>7</b>	Parandalimi i formimit të brymës	22
<b>Vendosja e zbutësit të ujit</b>	<b>8</b>	Lëvizja e pajisjes	22
Vendosja manuale	8	<b>Si të veprojmë nëse...</b>	<b>22</b>
Regjistrimi elektronik	9	<b>Të dhëna teknike</b>	<b>24</b>
<b>Përdorimi I kripës në enëlarëse</b>	<b>9</b>	<b>Udhëzime për instalimin</b>	<b>25</b>
<b>Përdorimi I lëndës shpëlarëse</b>	<b>10</b>	<b>Instalimi</b>	<b>25</b>
Rregullimi i dozimit të shpëlarësit	11	Mbështetja e sigurt në njësitë ngjitur	25
<b>Përdorimi I përditshëm</b>	<b>11</b>	Nivelimi	25
<b>Mbushja e enëlarëses me takëme dhe enë</b>	<b>12</b>	<b>Lidhja e ujit</b>	<b>25</b>
Koshi i poshtëm	13	Lidhjet e furnizimit me ujë	25
Koshi i takëmeve	13	Tubi i hyrjes së ujit me valvulën e sigurisë	26
Koshi i sipërm	14	Lidhja e tubit të daljes së ujit	26
Rregullimi i lartësisë së koshit të sipërm	15	<b>Lidhja elektrike</b>	<b>28</b>
<b>Përdorimi I detergjentit</b>	<b>15</b>	<b>Probleme që lidhen me mjedisin</b>	<b>28</b>
Mbushja me detergjent.	16	Materialet paketuese	28
<b>Funksioni I shumëfishtë</b>	<b>17</b>		

Rezervohet mundësia e ndryshimeve.

## Udhëzimet e funksionimit



### Të dhëna për sigurinë



Në interes të sigurisë tuaj si dhe për një përdorim të saktë, përpara se të instaloni dhe të përdorni për herë të parë pajisjen, lexoni me kujdes këtë manual të përdoruesit, duke përfshirë këshillat dhe paralajmërimet. Për të shmangur gabime dhe aksidente të panevojshme, është e rëndësishme që të gjithë personat që do të përdorin këtë pajisje, të njohin mirë mënyrën e përdorimit dhe veçoritë e sigurisë. Ruajini këto udhëzime dhe sigurohuni që t'i bashkëngjiten pajisjes në rast se do ta falni apo do ta shisni atë, në mënyrë që kushdo që do ta përdorë gjatë jetëgjatësisë së saj, të jetë i mirinformuar për përdorimin e pajisjes dhe sigurinë ndaj saj.

### Përdorimi i saktë

- Enëlarësja është ndërtuar vetëm për larjen e takëmeve shtëpiake të përshtatshme për larjen në enëlarëse.
- Mos fusni tretës në enëlarëse. Kjo mund të shkaktojë shpërthim.
- Thikat dhe takëmet e tjera me majë të mprehtë duhet të vendosen në koshin e takëmeve me majat e drejtuara poshtë ose të vendosen të shtrira horizontalisht në koshin e sipërm.
- Përdorni vetëm produkte (detergjent, kripë dhe shpëlarës) të përshtatshme për enëlarëset.
- Mos hapni derën, ndërsa pajisja është në punë e sipër, pasi mund të dalë që andej avull i nxehtë.
- Mos nxirrni nga enëlarësja asnjë enë, përpara se të mbarojë cikli i larjes.
- Pas përdorimit, shkëputeni pajisjen nga rrjeti elektrik dhe mbyllni çelësin e furnizimit me ujë.
- Ky produkt duhet të rishikohet vetëm nga një inxhinier i autorizuar shërbimi, si dhe duhen përdorur vetëm pjesë këmbimi origjinale.
- Në asnjë rast mos u përpiqni të riparoni pajisjen vetë. Riparimet e kryera nga persona pa përvojë, do të shkaktojnë plagosje ose keqfunksionim serioz. Kontaktoni Qendrën lokale të Shërbimit. Këmbëngulni gjithmonë në përdorimin e pjesëve të këmbimit origjinale.

### Siguria e përgjithshme

- Personat (duke përfshirë fëmijët) me aftësi fizike dhe mendore të kufizuara pse me mungesë përvojë dhe njohurish nuk duhet ta përdorin pajisjen. Këta njerëz duhet të jenë nën mbikëqyrje ose të udhëzohen për përdorimin e pajisjes, nga një person përgjegjës për sigurinë e tyre.
- Detergjentët e enëlarësës mund të shkaktojnë djegie kimike të syve, gojës apo fytit tuaj. Ato mund të rrezikojnë jetën tuaj! Respektoni udhëzimet e sigurisë së prodhuesit të detergjentit të enëlarësës.
- Uji brenda pajisjes tuaj nuk është i pijshëm. Mbetjet e detergjentit mund të kenë mbetur ende brenda pajisjes tuaj.
- Sigurohuni që dera e enëlarësës të jetë gjithmonë e mbyllur, gjatë kohës që nuk është duke u mbushur apo zbratur me enë. Në këtë mënyrë, do të shmangni rrezikun që dikush të pengohet apo lëndohet tek dera.
- Mos u ulni e mos peshoni mbi derën e hapur.

## Siguria e fëmijëve

- Kjo pajisje është ndërtuar për t'u përdorur nga të rriturit. Mos i lejoni fëmijët të përdorin enëlarësen pa mbikqyrje.
- Mbajini të gjitha materialet e paketimit larg fëmijëve. Ka rrezik asfiksimi.
- Mbajini të gjithë detergjentët në një vend të sigurt e të paarrtshëm për fëmijët.
- Mbajini fëmijët larg enëlarëses, gjatë kohës që dera e saj është e hapur.

## Instalimi


- Kontrollojeni enëlarësen tuaj për ndonjë dëmtim gjatë transportit. Mos vini kurrë në punë një pajisje të dëmtuar. Nëse enëlarësja juaj është e dëmtuar, kontaktoni shitësin tuaj.
- Përpara përdorimit, pajisja duhet shpaketuar tërësisht.
- Çdo ndërhyrje elektrike apo hidraulike e nevojshme për instalimin e kësaj pajisjeje, duhet kryer nga një person i kualifikuar dhe i aftë.
- Për arsye sigurie, është e rrezikshme të ndryshoni specififikimet apo të përpiqeni ta modifikoni këtë produkt në çdo mënyrë të mundshme.
- Mos e vini kurrsesi enëlarësen në punë, nëse kablllo i ushqimit dhe tubat e ujit janë të dëmtuar. apo nëse paneli i kontrollit, pjesa e sipërme ose bazamenti janë të dëmtuara në atë mënyrë që brendësia e pajisjes është lehtësisht e arritshme. Kontaktoni qendrën lokale të Shërbimit, në mënyrë që të shmangni rrezikun.
- Asnjë nga anët e pajisjes nuk duhet shpuar, në mënyrë që të parandalohen dëmtime të pjesëve hidraulike dhe elektrike.



### **PARALAJMËRIM**


Për lidhjet elektrike dhe ato me ujin, ndiqni me kujdes udhëzimet e dhëna në paragrafët e veçantë.

## Përshkrim i produktit






- 1 Koshi i sipërm
- 2 Rregulluesi i fortësisë së ujit
- 3 Mbjajtësja e kripës
- 4 Foleja e detergjentit
- 5 Foleja e shpëlarësit
- 6 Pllakëza e parametrave
- 7 Filtrat
- 8 Krahu i poshtëm spërkatës
- 9 Krahu i sipërm spërkatës

## Paneli i kontrollit



- 1 Butoni i përzgjedhjes së programit
- 2 Butoni MULTITAB
- 3 Butoni i shtyrjes së programit
- 4 Dritat treguese
- 5 Butoni On/off (ndez/fik)
- 6 Butonat e funksionit

Dritat treguese	
Kripa 	Ndizet kur është mbaruar kripa e posaçme. <sup>1)</sup>
Lënda shpëlarëse 	Ndizet kur shpëlarësi është mbaruar. <sup>1)</sup>
Përfundimi i programit 	Ndizet kur programi larës ka përfunduar. Ka gjithashtu edhe funksione të sinjalizimit viziv, gjatë: - Vendosja e zbutësit të ujit - aktivizimi/çaktivizimi i sinjaleve akutsike - ndërhyrja e një alarmi për shkak të keqfunksionimit të pajisjes

1) Dritat treguese të kripës dhe shpëlarësit nuk ndizen gjatë kohës që një program larës është në proces, edhe nëse është e nevojshme të shtoni kripë dhe/ose shpëlarës.

### Butonat e funksionit

Krahas përzgjedhjes së programit,

- përzgjedhja e zbutësit të ujit
  - aktivizimi/çaktivizimi i folesë së shpëlarësit
  - aktivizimin/çaktivizimin e sinjaleve akustike
- mund të vendosen me ndihmën e këtyre butonave.

## Modaliteti i përzgjedhjes

Pajisja është në modalitetin e përzgjedhjes kur dritat e butonit të programit **all** janë të ndezura.



Mbani gjithmonë parasysh kur kryeni procese të tilla si:

- të përzgjidhni një program larjeje
  - përzgjedhjen e zbutësit të ujit
  - aktivizimin/çaktivizimin e mbajtëses së shpëlarësit
  - aktivizimin/çaktivizimin e sinjaleve akustike
- pajisja **DUHET** të jetë në modalitetin e përzgjedhjes.

Nëse drita e një programit është e ndezur, programi i fundit i kryer ose i përzgjedhur do të vazhdojë të jetë i ruajtur.

Në këtë rast, për t'u kthyer në modalitetin e përzgjedhjes, duhet të anuloni programin.

**Për të anuluar një program të regjistruar ose një program në proces e sipër** : shtypni njëkohësisht dhe mbani shtypur butonat e programit që ndodhen mbi fjalën RESET, derisa të ndizen të gjitha dritat e programit. Programi është anuluar dhe pajisja tani është në modalitetin e përzgjedhjes.

## Sinjalet akustike



Sinjalet akustike kanë për qëllim t'ju tregojnë se cilat procese është duke kryer pajisja:

- përzgjedhjen e zbutësit të ujit
- fundi i programit të larjes
- ndërhyrjen e një alarmi si shkak i keqfunksionimit.

Përzgjedhja e vendosur nga fabrika: sinjalet akustike të aktivizuara.

Është e mundur të çaktivizoni sinjalet akustike, duke përdorur butonat e funksionit.

### Çaktivizimi/aktivizimi i sinjaleve akustike

1. Shtypni butonin **On/Off** . Pajisja duhet të jetë në **modalitetin e përzgjedhjes** .
2. Shtypni njëkohësisht butonat **B** dhe **C** , derisa dritat e butonave **A** , **B** , dhe **C** të fillojnë të pulsojnë.
3. Shtypni butonin **C** , dritat e butonave **A** dhe **B** fiken, ndërsa drita e butonit **C** vazhdon të pulsojë. Drita treguese e **Përfundimit të programit** ndizet në të njëjtën kohë, duke treguar që sinjalet akustike janë aktive.
4. Për të çaktivizuar sinjalet akustike, shtypni sërish butonin **C** : drita e **Përfundimit të programit** fiket duke treguar që sinjalet akustike janë çaktivizuar.
5. Për të regjistruar procesin, fikni enëlarësen.
6. Për të aktivizuar sërish sinjalet akustike, mjafton të ndiqni hapat e mësipërm derisa drita treguese e **Përfundimit të programit** të ndizet.

## Përdorimi i parë

Përpara se të përdorni enëlarësen për herë të parë:

- Sigurohuni që lidhjet elektrike dhe ato hidraulike të jenë në përputhje me udhëzimet e instalimit
- Hiqni gjithë paketimet nga brendësia e pajisjes
- Vendosni zbutësin e ujit.

- Hidhni 1 litër ujë brenda mbajtëses së kripës dhe më pas mbusheni atë me kripë të përshtatshme për enëlarësen
- Mbushni folenë e shpëlarësit

**i** Nëse dëshironi të përdorni tableta detergjente të kombinuara, si: "3 në 1", "4 në 1", "5 në 1" etj... zgjidhni funksionin e Multi-tab (shihni "funksioni Multi-tab").

## Vendosja e zbutësit të ujit

Enëlarësja është e pajisur me një impiant për zbutjen e ujit, i ndërtuar për të hequr mineralet dhe kripërat që hyjnë bashkë me ujin, çka do të kishte një ndikim të dëmshëm dhe të pafavorshëm për funksionimin e rregullt të pajisjes.

Sa më e lartë të jetë përmbajtja e këtyre mineraleve dhe kripërave, aq më i fortë është uji. Fortësia e ujit matet në shkallët përkatëse të çdo vendi, gradë Gjermane (°dH), gradë Franceze (°TH) dhe mmol/l (milimol për litër - njësi ndërkombëtare për fortësinë e ujit). Funksioni i zbutjes së ujit duhet të rregullohet sipas fortësisë së ujit në zonën tuaj. Autoritetet përkatëse të Ujësjetësit, mund t'ju informojnë mbi fortësinë e ujit në zonën tuaj.


Funksioni i zbutjes së ujit mund të vendoset në të dyja mënyrat: manualisht, duke përdorur rregulluesin e fortësisë së ujit, si dhe elektronikisht

Fortësia e ujit			Rregullimi i përzgjedhjes së fortësisë së ujit		Përdorimi i kripës
°dH	°TH	mmol/l	manualisht	elektronikisht	
51 - 70	91 - 125	9,1 - 12,5	2	niveli 10	po
43 - 50	76 - 90	7,6 - 8,9	2	niveli 9	po
37 - 42	65 - 75	6,5 - 7,5	2	niveli 8	po
29 - 36	51 - 64	5,1 - 6,4	2	niveli 7	po
23 - 28	40 - 50	4,0 - 5,0	2	niveli 6	po
19 - 22	33 - 39	3,3 - 3,9	2	niveli 5	po
15 - 18	26 - 32	2,6 - 3,2	1	niveli 4	po
11 - 14	19 - 25	1,9 - 2,5	1	niveli 3	po
4 - 10	7 - 18	0,7 - 1,8	1	niveli 2	po
<4	<7	< 0,7	1	niveli 1	jo

## Vendosja manuale

**i** Enëlarësja është paravendosur në përzgjedhjen 2.

1. Hapni derën e enëlarësës.
2. Nxirreni koshin e poshtëm nga enëlarësja.
3. Kthejeni rregulluesin e fortësisë së ujit në pozicionin 1 ose 2 (shihni tabelën).
4. Rivendosni koshin e poshtëm.



## Regjistrimi elektronik

**i** Enëlarësja është paravendosur në përzgjedhjen 5.

1. Shtypni butonin On/Off. Enëlarësja duhet të jetë në modalitetin e përzgjedhjes.
2. Shtypni njëkohësisht dhe mbajini shtypur butonat **B** dhe **C**, derisa dritat e butonave **A**, **B**, dhe **C** të fillojnë të pulsojnë.
3. Shtypni butonin **A**, dritat e butonave **B** dhe **C** fikën, ndërsa drita e butonit **A** vazhdon të pulsojë. Drita treguese e **Përfundimit të programit** fillon të pulsojë njëkohësisht së bashku me sinjalet akustike me ndërprerje. Niveli aktual tregohet nga numri i pulsimeve të dritës treguese të **Përfundimit të programit**, (shihni tabelën) së bashku me një sërë sinjalesh akustike me ndërprerje dhe me një pauzë prej pak sekondash.

### Shembuj:

5 pulsime / 5 sinjale akustike me ndërprerje, pauzë, 5 pulsime / 5 sinjale akustike me ndërprerje, pauzë = niveli 5

4. Për të ndryshuar nivelin, shtypni butonin **A**. Niveli ndryshon me çdo shtypje të këtij butoni. (Për zgjedhjen e nivelit të ri, shihni tabelën).

**Shembuj:** nëse niveli aktual është 5, duke shtypur butonin **A** një herë, zgjidhni nivelin 6. nëse niveli aktual është 10, duke shtypur butonin **A** një herë, zgjidhni nivelin 1.

5. Për të regjistruar procesin, fikni enëlarësen duke shtypur butonin On/Off.

## Përdorimi I kripës në enëlarëse




### PARALAJMËRIM

Përdorni vetëm kripën e prodhuar posaçërisht për përdorim në enëlarëse. Të gjitha llojet e tjera të kripës që nuk janë të përshtatshme për përdorimin në enëlarëse, veçanërisht tabletat e kripës, do të dëmtojnë impiantin e zbutjes së ujit. Hidhni kripën brenda, vetëm përpara se të filloni një nga programet e plota të larjes. Kjo do të pengojë çdo grimcë të kripës apo ujë të kripur, që mund të jetë shpërndarë, të depozitohen në fund të pajisjes për çdo periudhë kohore, gjë që mund të sjellë gjërryerje.

### Për mbushjen:

1. Hapni derën, nxirreni jashtë koshin e poshtëm dhe zhvidhosni kapakun e mbajtëses së kripës duke e rrotulluar atë në drejtim kundërorar.
2. Hidhni 1 litër ujë brenda në mbajtëse (**kjo është e nevojshme vetëm përpara se të hidhni kripën për herë të parë**).

3. Me anën e hinkës që keni marrë bashkë me pajisjen, hidhni kripën derisa mbajtësja të jetë mbushur plot.
4. Rivendoseni kapakun duke u siguruar se nuk ka mbetur asnjë gjurmë kripe në vidën e filetuar ose në guarnicion.
5. Rivendoseni kapakun sërish duke e rrotulluar në drejtim orar, derisa të ndalojë me një kërcitje.



**i** Mos u shqetësoni nëse uji derdhet nga njësia kur jeni duke hedhur kripën, kjo është më se normale.

**i** Drita treguese e kripës në panelin e kontrollit mund të mbetet e ndezur për 2-6 orë pasi keni rimbushur mbajtësen me kripë, nëse enëlarësja do të qëndrojë e ndezur. Nëse përdorni kripëra, të cilave u duhet më shumë kohë që të shkrijnë, atëherë kjo mund të kërkojë më shumë kohë. Funksionimi normal i pajisjes nuk ndikohet.

## Përdorimi I lëndës shpëlarëse



### PARALAJMËRIM

Përdorni vetëm shpëlarës origjinalë të përshtatshëm për enëlarëse.


Mos e mbushni kurrë folenë e shpëlarësit me substanca të tjera (p.sh. agjentë pastrues për enëlarësen, detergjent të lëngshëm). Kjo do ta dëmtonte pajisjen.




Shpëlarësi siguron një shpëlarje të plotë si dhe shmang tharjen e stërkalave dhe rrëqeve nëpër enë.

Shpëlarësi shtohet automatikisht gjatë procesit të fundit të shpëlarjes.

1. Hapni mbajtësen duke shtypur dhe lëshuar butonin (A).



2. Hidhni shpëlarësin në folenë përkatëse. Niveli maksimal i mbushjes tregohet nga shenja "max".  
Mbajtësja mban afro 110 ml shpëlarës, që është i mjaftueshëm për ciklet e larjes midis 16 dhe 40, në varësi të përzgjedhjes së sasisë.
3. Sigurohuni që kapaku të jetë mbyllur pas çdo rimbushjeje.



- i** Pastroni me një leckë thithëse çdo rrjedhje shpëlarësi gjatë mbushjes, për të shmangur shkumëzimin e tepërt gjatë larjes së ardhshme.


## Rregullimi i dozimit të shpëlarësit

- i** Në varësi të rezultateve të arritura të shkëlqimit dhe tharjes, rregulloni dozimin e shpëlarësit me anën e përzgjedhësit me 6 pozicione (ku pozicioni 1= dozimi minimal, pozicioni 6= dozimi maksimal).

Dozimi është pararendosur në përzgjedhjen 4.

Rriteni dozimin nëse nëpër enë kanë mbetur pika uji apo njolla rrëqeje.

Pakësojeni atë nëse nëpër enë kanë mbetur të ngjitura rrëqe të bardha apo një shtresë e turbullt nëpër qelqurina apo tehet e thikave.



## Përdorimi I përditshëm

- Kontrolloni nëse është e nevojshme të rimbushni enëlarësen me kripë apo shpëlarës.
- Vendosni takëmet dhe enët në enëlarëse.
- Hidhni detergjentin e enëlarëses.
- Zgjidhni një program larjeje të përshtatshëm për takëmet dhe enët.
- Filloni programin e larjes.

## Mbushja e enëlarëses me takëme dhe enë

Sfungjerët, lecat shtëpiake dhe çdo objekt që mund të thithë ujë, nuk duhet të lahen në enëlarëse.

- Përpara se të fusni brenda enët, duhet:
  - Të hiqni prej tyre gjithë ushqimet apo copëzat e mbetura të ushqimit.
  - Zbutni mbetjet e djegura të ushqimeve në tiganë
- Kur vendosni brenda enët dhe takëmet, lutemi vini re:
  - Enët dhe takëmet nuk duhet të pengojnë rrotullimin e krahëveve spërkatës.
  - Sendet e zgavruara, si filxhanët, gotat, tiganët, etj. vendosini me zgavrën nga poshtë, në mënyrë që të mos mblidhet ujë në mbajtëse apo në bazamentin e tyre.
  - Enët dhe takëmet nuk duhet të vendosen brenda njëra-tjetrës apo njëra mbi tjetrën.
  - Për të shmangur dëmtime të mundshme në qelqurina, vendosni në mënyrë të tillë që të mos takojnë njëra-tjetrën.
  - Vendosni objektet e vogla në koshin e takëmeve.
- Sendet plastike dhe tiganët me veshje të posaçme për mos-ngjitje, janë të prirur të mbajnë pikat e ujit; këto sende nuk do të thahen aq mirë sa sendet prej porcelani apo çeliku.
- Sendet e lehta (tasat plastike, etj.) duhet të vendosen në koshin e sipërm në mënyrë të tillë që të mos lëvizin.


### Për larjen në enëlarëse, takëmet dhe enët e mëposhtme

nuk janë të përshtatshme:	kanë kufizimet e tyre në përshtatjen me enëlarësen:
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Takëmet me bisht të drunjtë, të brinjë, kinez apo prej sedefi.</li> <li>• Sendet plastike që nuk janë rezistente ndaj në nxehtit.</li> <li>• Takëme të vjetra me pjesë të ngjitura që nuk i rezistojnë temperaturës.</li> <li>• Takëme apo enë të shtresëzuara.</li> <li>• Sende kallaji apo bronzi.</li> <li>• Qelqurina prej kristali plumbi.</li> <li>• Sende prej çeliku të prirur për t'u ndryshkur.</li> <li>• Pjatanca prej druri.</li> <li>• Sende të përbëra nga fibra sintetike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimet e gresit lajini në enëlarëse vetëm nëse është shënuar mbi to nga prodhuesi, se janë të përshtatshme për larjen në enëlarëse.</li> <li>• Motivet me glazurë mund të çngjyrosen nëse i lani shpesh në enëlarëse.</li> <li>• Pjesët prej argjendi dhe alumini janë të prirur të çngjyrosen gjatë larjes: Mbetjet, si p.sh. prej të bardhave të vezës, të verdhave të vezës dhe mustardës shkaktojnë shpesh çngjyrosje dhe njollosje mbi sendet prej argjendi. Për këtë arsye, gjithmonë pastrojeni argjendin menjëherë nga këto mbetje, nëse nuk do t'i lani menjëherë pas përdorimit të tyre.</li> </ul>


Hapni derën dhe rrëshqisni jashtë koshat për të vendosur në to enët.

## Koshi i poshtëm

Vendosni pjatat dhe tiganët më të ndotur në koshin e poshtëm.



Për të lehtësuar vendosjen e enëve më të mëdha, 2 mbajtëset e pjatave në të djathtë në koshin e poshtëm mund të palosen poshtë.



## Koshi i takëmeve




### PARALAJMËRIM

Pozicioni i vendosjes së thikave me tehtë gjatë me tehtëun nga sipër është shumë i rrezikshëm. Takëmet e gjata dhe/ose të mprehta, si thikat e mëdha të mishit duhet të vendosen horizontalisht në koshin e sipërm. Bëni kujdes kur futni ose nxirrni nga pajisja sende të mprehta, si thikat.


Për t'u siguruar se gjithë takëmet e vendosur në koshin e takëmeve janë të arritshme nga uji, ju duhet:

1. Vendosi skarën mbi koshin e takëmeve.



2. Vendosi pirunjtë dhe lugët në koshin e takëmeve me dorëzat nga poshtë.


Për takëmet më të mëdha, si rrahëset e vezëve, vendosni vetëm deri në gjysmë skarën e takëmeve.




## Koshi i sipërm

Vendosi enët e vogla dhe delikate prej argjile dhe takëmet e gjata dhe të mprehta në koshin e sipërm.

- Vendosi enët prej argjile mbi dhe nën varëset e palosshme të filxhanëve, në mënyrë që të jenë të shkëputura nga njëra-tjetra e uji të mund t'i arrijë të gjitha enët.



- Varëset e filxhanëve mund të palosen duke liruuar hapësirën për enët e larta të argjilës.
- Vendosni shtrirë ose varni gotat e verës dhe të pijes në zgavrat që ndodhen në varëset e filxhanëve.



## Rregullimi i lartësisë së koshit të sipërm


	Lartësia maksimale e enëve në:	
	koshin e sipërm	koshin e poshtëm.
Me koshin e sipërm të ngritur	22 cm	30 cm
Me koshin e sipërm të ulur	24 cm	29 cm

**i** Lartësia e koshit të sipërm gjithashtu mund të rregullohet kur është i mbushur me enë.

### Ngritja / ulja e lartësisë së koshit të sipërm:

1. Tërhiqni tërësisht jashtë koshin e sipërm.
2. Duke e mbajtur koshin e sipërm nga doreza, ngrijeni atë deri ku të shkojë dhe më pas uleni atë vertikalisht.

Koshi i sipërm do të fiksohet në pozicionin më të ulët apo më të sipërm të zgjedhur.



### **!** PARALAJMËRIM

Menjëherë pasi ngarkoni pajisjen, mbylleni gjithmonë derën, pasi dera e hapur mund të jetë e rrezikshme.

**i** Përpara se të mbyllni derën, sigurohuni se krahët spërkatës mund të rrotullohen lirisht.


## Përdorimi I detergjentit

**i** Përdorni vetëm detergjent të prodhuar posaçërisht për përdorimin në enëlarëse. Lutemi lexoni me kujdes këshillat e prodhuesit për dozimin dhe ruajtjen, siç shkruhet në paketimin e detergjentit.


**🌿** Mospërdorimi i një sasive më të madhe se ç'duhet detergjenti, ndihmon në pakësimin e papastërtive.

## Mbushja me detergjent.


1. Hapni kapakun.



2. Mbusheni folenë e detergjentit (1) me detergjent. Shenjat brenda saj tregojnë nivelet e dozimit:  
20 = përfaqëson 20 g detergjent  
30 = përfaqëson 30 g detergjent
3. Gjithë programet me paralarje kanë nevojë për një sasi shtesë detergjenti (5/10 g), e cila duhet të vendoset në folenë e posaçme të detergjentit për paralarje (2).  
Ky detergjent do të veprojë gjatë fazës së paralarjes.



4. Kur përdorni tableta detergjente, vendosini ato në folenë (1)
5. Mbyllni kapakun dhe shtypeni derisa të mbërthehet mirë.



### Tabletat detergjente

Tabletat detergjente të prodhuesve të ndryshëm shkrijnë në nivele të ndryshme. Si rrjedhojë, disa tableta detergjente nuk e arrijnë fuqinë e tyre maksimale larëse gjatë programeve të shkurtra të larjes. Për këtë arsye, ju lutemi përdorni programe të gjata të larjes kur përdorni tableta detergjente, për të siguruar heqjen e plotë të mbetjeve të detergjentit.

## Funksioni I shumëfishtë

Kjo pajisje është e pajisur me "funksionin Multi-Tab", i cili mundëson përdorimin e tabletave detergjente të kombinuara "Multi-Tab".

Këta produkte janë detergjentë me një funksion të kombinuar të larjes, shpëlarjes dhe kripës. Ata gjithashtu përmbajnë agjentë të tjerë të ndryshëm, në varësi të llojit të tabletës që zgjidhni ("3 në 1", "4 në 1", "5 në 1" etj...).

Kontrolloni nëse detergjentet janë të përshtatshëm për fortësinë e ujit tuaj. Shihni udhëzimet e prodhuesit.

Ky funksion mund të përzgjidhet për gjithë programet e larjes. Me zgjedhjen e këtij funksioni, derdhja në pajisje e shpëlarësit dhe kripës nga çdo fole përkatëse çaktivizohet automatikisht si dhe dritat treguese për kripën dhe shpëlarësin janë çaktivizuar.

Zgjidhni "funksionin Multitab" përpara fillimit të një programi larës.

Pasi është zgjedhur ky funksion (drita treguese është ndezur), ai do të mbetet i aktivizuar gjithashtu edhe për programet e tjera të larjes.

Me përdorimin e "funksionit Multitab", kohëzgjatjet e cikleve mund të ndryshojnë.

Në momentin që programi ka filluar procesin, "funksioni Multitab" NUK mund të ndryshohet më. Nëse dëshironi të çaktivizoni "funksionin Multitab" duhet të anuloni përzgjedhjen e programit e më pas të çaktivizoni "funksionin Multitab".

Në këtë rast duhet të rizgjidhni një program larës (si dhe përzgjedhjet e dëshiruara).

### Aktivizimi/çaktivizimi i funksionit Multitab

Shtypni butonin Multitab: drita treguese përkatëse do të ndizet. Kjo do të thotë se funksioni është aktiv.

Për të çaktivizuar funksionin, shtypni sërish butonin Multitab: drita treguese përkatëse do të fiket.



#### **Nëse nuk jeni të kënaqur nga rezultatet e tharjes, ju këshillojmë:**

1. Të mbushni mbajtësen e shpëlarësit me shpëlarës.
  2. Të aktivizoni mbajtësen e shpëlarësit.
  3. Të vendosni dozimin e shpëlarësit në pozicionin 2.
- Aktivizimi/çaktivizimi i folesë së shpëlarësit mund të jetë i mundur vetëm me "funksionin Multitab" të aktivizuar.

#### **Aktivizimi/çaktivizimi i mbajtëses së shpëlarësit**

1. Shtypni butonin On/Off. Enëlarësja duhet të jetë në modalitetin e përzgjedhjes.
2. Shtypni njëkohësisht butonat **B** dhe **C**, derisa dritat e butonave **A**, **B**, dhe **C** të fillojnë të pulsojnë.
3. Shtypni butonin **B**, dritat e butonave **A**, dhe **C** fiken, ndërsa drita e butonit **B** vazhdon të pulsojë: drita treguese e përfundimit të programit ndizet, duke treguar se mbajtësja e shpëlarësit është aktivizuar.
4. Për të ndryshuar përzgjedhjen, shtypni butonin **B** sërish, derisa drita treguese e përfundimit të programit fiket.
5. Për të regjistruar procesin, fikni enëlarësen duke shtypur butonin On/Off.

**i** Nëse vendosni të ktheheni mbrapsht në përdorimin e sistemit standard të detergjentit, ju këshillojmë:

1. Të çaktivizoni "funksionin Multi-Tab.
2. Të mbushni sërish mbajtëset përkatëse të kripës dhe shpëlarësit.
3. Të rregulloni përzgjedhjen e fortësisë së ujit në nivelin më të lartë dhe të kryeni 1 program larës normal pa futur asnjë enë brenda në pajisje.
4. Të rregulloni përzgjedhjen e zbutjes së ujit sipas fortësisë së ujit në zonën tuaj.
5. Të rregulloni dozimin e shpëlarësit.

## Programet e larjes

Programi	Niveli i ndotjes	Lloji i ngarkesës	Përshkrimi i programit					Vlerat e konsumit <sup>1)</sup>		
			Paralarja	Larja kryesore	Shpëlarja e ndërmjetme	Shpëlarja përfundimtare	Tharja	Kohëzgjatja (minuta)	Energjia (kWh)	Uji (litra)
INTENSIV CARE 70°	Ndotje e madhe	Enë argjile, takëme, tenxhere dhe tiganë	●	●	●	●	●	140 - 150	1,5 - 1,7	16 - 18
AUTO <sup>2)</sup>	Ndotje e përzier, normale ose e madhe	Enë argjile, takëme, tenxhere dhe tiganë	●	●	1/2x	●	●	90 - 115	1,1 - 1,5	12 - 23
30 MIN <sup>3)</sup>	Ndotje e lehtë	Enë argjile dhe takëme		●		●		30	0,9	9
ECO 50° <sup>4)</sup>	Ndotje normale	Enë argjile dhe takëme	●	●	●	●	●	150 - 160	1,0 - 1,2	12 - 14

1) Vlerat e konsumit janë si udhëzues për ju dhe varen nga presioni dhe temperatura e ujit si dhe nga ndryshimet e ushqimit me energji elektrike dhe sasia e enëve të ngarkuara.

2) Gjatë programit Automatik të larjes, niveli i ndotjes në enë përcaktohet se sa i turbullt është uji. Kohëzgjatja e programit, nivelet e konsumit të ujit dhe energjisë mund të ndryshojnë; kjo varet nga fakti nëse pajisja është e ngarkuar plotësisht apo pjesërisht si dhe nëse enët janë pak ose shumë të ndotura. Temperatura e ujit rregullohet automatikisht midis 45° C dhe 70° C.

3) Ideale për larjen në një pajisje të mbushur pjesërisht. Ky është programi ditor i përkryer, për të mbuluar nevojat e një familjeje me 4 persona që duan të lajnë në enëlarëse vetëm enët e mëngjesit dhe drekës, si enë argjile dhe takëme.

4) Program testimi për institutet e testimit.

## Përzgjedhja dhe startimi I një programi larës



Përzgjidhni programin e larjes dhe shtyrjen e fillimit të programit me derën pak të hapur. Fillimi i programit ose numërimi mbrapsht deri në fillimin e shtyrë të programit, do të aktivizohen vetëm pasi të keni mbyllur derën. Deri në atë moment, është e mundur të ndryshoni përzgjedhjet.

1. Kontrolloni që koshat të jenë ngarkuar në mënyrë të saktë si dhe që krahët spërkatës të jenë të lirshëm për t'u rrotulluar.
2. Kontrolloni që rubineti i ujit të jetë i hapur.
3. Shtypni butonin On/Off: të gjitha dritat e programit do të ndizen (modaliteti i përzgjedhjes).
4. Shtypni butonin që përkon me programin e kërkuar (shihni tabelën "Programet larës"). Drita përkatëse e programit të përzgjedhur do të ndizet.

Mbyllni derën e enëlarëses, programi do të fillojë automatikisht.

### Regjistrimi dhe fillimi i programit me funksionin e "shtyrjes së programit"

1. Pasi të keni zgjedhur një program larës, shtypni butonin e shtyrjes së programit derisa drita që përkon me orët e zgjedhura, të pulsojë (3h, 6h ose 9h).
2. Mbyllni derën e enëlarëses, numërimi mbrapsht do të fillojë automatikisht.
3. Numërimi mbrapsht do të ecë me nga 3 orë.
4. Hapja e derës do të shkaktonte ndërprerje të numërimit mbrapsht.
5. Pasi numërimi mbrapsht i kohës të ketë mbaruar, programi do të fillojë automatikisht.

### Anulimi i "shtyrjes së programit" dhe / ose i një programi larjeje

- Për të anuluar shtyrjen e fillimit të programit në proces e sipër, duhet të riaktivizoni enëlarësen.
- Me anulimin e shtyrjes së fillimit të programit, anulohet gjithashtu edhe programi i regjistruar. Në këtë rast duhet të regjistroni sërish programin larës. Nëse duhet të zgjidhni një program të ri larës, kontrolloni që foleja e detergjentit të jetë e mbushur me detergjent.



### PARALAJMËRIM

Ndërpritni ose anuloni një program larjeje në proces e sipër, VETËM nëse është tepër e nevojshme. Kujdes! Kur dera është e hapur mund të dalë që andej avull i nxehtë. Hapeni derën me kujdes.

### Ndërprerja e një programi larës në proces e sipër:

- Hapni derën e enëlarëses; programi do të ndalojë. Mbylleni derën; programi do të fillojë nga momenti në të cilin u ndërpre.
- Shtypni butonin On/Off, të gjitha dritat do të fiken. Shtypni sërish butonin On/Off; programi do të fillojë nga momenti në të cilin u ndërpre.

### Përfundimi i programit të larjes

- Enëlarësja do të ndalojë automatikisht.
  - Sinjali akustik do t'ju informojë për përfundimin e programit.
  - Hapni derën e enëlarëses.
  - Drita treguese e përfundimit të programit do të ndizet.
  - Drita e programit të sapo përfunduar do të qëndrojë e ndezur.
1. Fikni enëlarësen duke shtypur butonin On/Off.

2. Lëreni derën pak të hapur dhe prisni pak minuta përpara se të nxirrni jashtë enët; në këtë mënyrë ato do të jenë më të ftohta dhe tharja do të bëhet më mirë.

## Zbrazja e enëlarëses

- Enët e nxehta janë të ndjshme ndaj goditjeve  
Për këtë arsye, enët duhen lënë të ftohen përpara se të nxirren nga pajisja.
- Boshatisni koshin e poshtëm në fillim e më pas atë të sipërmin; kjo do të shmangë rrjedhjen e ujit nga koshi i sipërm në enët që ndodhen në koshin e poshtëm.
- Në anët e derës së enëlarëses mund të shfaqet ujë ndërsa pjesët prej inoksi do të ftohen më shumë se enët.



### KUJDES

Kur programi i larjes ka përfunduar, këshillohet që të hiqni nga prizja enëlarësen dhe të mbyllni rubinetin e ujit.

## Kujdesi dhe pastrimi

### Pastrimi i filtrave


Filtrat duhet të kontrollohen e të pastrohen herë pas here. Filtrat e ndotur do të përkeqësojnë rezultatin e larjes.




### PARALAJMËRIM

Përpara se të pastroni filtrat, sigurohuni që pajisja të jetë e fukur.


1. Hapni derën, hiqni koshin e poshtëm.
2. Sistemi i filtrave të enëlarëses përmban një filtër të trashë (A), një mikrofiltër (B) dhe një mikrofiltër të rrafshët. Zbërthejeni sistemin e filtrave duke përdorur dorezën e mikrofiltrit, dhe nxirrni sistemin e filtrave.



3. Kthejeni dorezën me një rrotullim pothuajse 1/4 në drejtim kundërorar dhe nxirri sistemin e filtrave.
4. Kapeni filtrin e trashë ( **A** ) nga doreza me vrimë dhe nxirri mikrofiltrin ( **B** ).
5. Pastroni gjithë filtrat plotësisht në ujë të rrjedhshëm.



6. Nxirri filtrin e rrafshët nga bazamenti i dhomës së larjes dhe pastrojini plotësisht nga të dyja anët.
7. Vendoseni sërish filtrin e rrafshët në bazamentin e dhomës së larjes dhe sigurohuni që të jetë vendosur mirë.
8. Vendoseni filtrin e trashë ( **A** ) brenda në mikrofiltrin ( **B** ) dhe shtypini të dyja bashkë.
9. Vendoseni sistemin e kombinuar të filtrave në vend dhe mbërthejeni duke e rrotulluar dorezën në drejtim orar derisa të ndalojë. Gjatë këtij procesi, sigurohuni që filtri i rrafshët të mos ketë dalë jashtë bazamentit të dhomës së larjes.



### PARALAJMËRIM

Mos e përdorni KURRË enëlarësen pa filtrat. Rivendosja dhe montimi i gabuar i filtrave do të sjellë rezultate të dobëta të larjes, si dhe mund të dëmtojë pajisjen.

### Pastrimi i krahëve spërkatës



Mos u përipiqi KURRË të çmontoni krahët spërkatës.

Nëse vrimat e krahëve spërkatës janë bllokuar nga mbetjet e ndotjeve, pastrojini ato me ndihmën e një kruajtëseje dhëmbësh.

### Pastrimi i jashtëm

Pastroni sipërfaqet e jashtme të pajisjes dhe panelin e kontrollit me një leckë të butë të njomë. Nëse është e nevojshme përdorni detergjent neutralë. Mos përdorni kurrë produkte gërryese, materiale të ashpra ose tretës (si aceton, trikloroetilen, etj....).

### Pastrimi i brendshëm

Sigurohuni që guarnicionet përreth derës, foletë e detergjentit dhe shpëlarësit të pastrohen rregullisht me një leckë të njomë.

Ju këshillojmë të kryeni çdo 3 muaj një program larjeje për enë të ndotura shumë, por pa enë brenda.

## Kohë të gjata mos-përdorimi

Nëse nuk do ta përdorni pajisjen për një periudhë të gjatë, ju këshillojmë:

1. Të hiqni pajisjen nga priza e më pas të mbyllni ujin.
2. Të lini derën pak të hapur për të shmangur formimin e erërave të pakëndshme.
3. Të lini të pastër brendësinë e pajisjes.

## Parandalim i formimit të brymës

Mos e vendosni pajisjen në një vend ku temperaturat shkojnë nën 0°C. Nëse kjo është pashmangshme, zbrazeni pajisjen, mbyllni derën e pajisjes, çmontojeni tubin e hyrjes së ujit dhe zbrazeni atë.

## Lëvizja e pajisjes

Nëse ju duhet të lëvizni pajisjen (kur ndërroni shtëpi, etj...):

1. Hiqeni atë nga priza.
2. Mbyllni rubinetin e ujit.
3. Hiqni tubin e hyrjes së ujit dhe zbrazeni tubat e gomuar.
4. Tërhiqeni pajisjen jashtë bashkë me tubat.

Bëni kujdes të mos anoni pajisjen gjatë zhvendosjes.

## Si të veprojmë nëse...

Enëlarësja nuk fillon punë ose ndalon në mes të procesit. Probleme të tilla vijnë si pasojë e mungesës së mirëmbajtjes së thjeshtë apo vëmendjes, çka mund të zgjidhet me ndihmën e treguesve të përshkruar në tabelë, pa qenë nevoja të thërrisni një inxhinier.

Fikeni enëlarësen dhe kryeni veprimet korrigjuese të sugjeruara më poshtë.

Kodi i defektit dhe keqfunksionimi	Shkaku i mundshëm dhe zgjidhja
<ul style="list-style-type: none"> <li>• pulsimit i vazhdueshëm i dritës së programit në proces,</li> <li>• 1 sinjal akustik me ndërprerje</li> <li>• 1 pulsimit i dritës treguese së <b>përfundimit të programit</b>,</li> </ul> <p>Enëlarësja nuk mbushet me ujë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rubineti i ujit është i bllokuar ose i veshur me shtresë gëlqerore.</li> <li>• Pastroni rubinetin e ujit.</li> <li>• Rubineti i ujit është i mbyllur. Hapeni rubinetin e ujit.</li> <li>• Filtri (atje ku ndodhet) në tubin e rrudhosur të lidhur me valvulën e hyrjes së ujit është bllokuar.</li> </ul> <p>Pastroni filtrin në tubin e rrudhosur.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tubi i hyrjes së ujit nuk është vendosur mirë ose është përthyer apo shkelur.</li> </ul> <p>Kontrolloni lidhjen e tubit të hyrjes së ujit.</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• pulsimit i vazhdueshëm i dritës së programit në proces,</li> <li>• 2 sinjale akustike me ndërprerje</li> <li>• 2 pulsime të dritës treguese të <b>përfundimit të programit</b>,</li> </ul> <p>Enëlarësja nuk e kullon ujin.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rubineti i lavapjatës është i bllokuar.</li> </ul> <p>Rubineti i lavapjatës është i bllokuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tubi i kullimit të ujit nuk është vendosur mirë ose është përthyer apo shkelur.</li> </ul> <p>Kontrolloni lidhjen e tubit të kullimit të ujit.</p>

Kodi i defektit dhe keqfunksionimi	Shkaku i mundshëm dhe zgjidhja
<ul style="list-style-type: none"> <li>• pulsime vazhdueshme i dritës së programit në proces,</li> <li>• 3 sinjale të dëgjueshëm me ndërprerje</li> <li>• 3 flashes of the <b>end of programme</b> indicator light,</li> </ul> Mekanizmi kundra-përmbetje është i aktivizuar.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbyllni rubinetin e ujit dhe kontaktoni Qendrën lokale të Shërbimit.</li> </ul>
Programi nuk fillon punën.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dera e enëlarëses nuk është mbyllur mirë. Mbylleni derën.</li> <li>• Spina kryesore nuk është në prizë. Vendosni spinën kryesore në prizë.</li> <li>• Ka rënë siguresa në kutinë e siguresave të shtëpisë. Riaktivizoni siguresën.</li> <li>• Është aktivizuar funksioni i shtyrjes së fillimit të programit. Nëse do t'i lani enët menjëherë, anuloni funksionin e shtyrjes së programit.</li> </ul>

Pasi t'i keni kryer këta kontrolle, ndizni pajisjen: programi do të vazhdojnë nga momenti në të cilin u ndërpre.

Nëse kodi i keqfunksionimit ose defektit rishfaqet, kontaktoni Qendrën e Shërbimit.

Lidhur me kode të tjera defekti që nuk janë përshkruar në tabelën e mësipërme, lutemi kontaktoni Qendrën lokale të Shërbimit, duke u treguar modelin (Mod.), numrin e produktit (PNC) dhe numrin e serisë (S.N.).

Ky informacion gjendet në pllakën e parametrave që ndodhet në anë të derës së enëlarëses.

Në mënyrë që t'i keni gjithmonë këta numra, ju këshillojmë t'i shënoni ato këtu:

Mod. : .....

PNC : .....

S.N. : .....

Rezultatet e larjes nuk janë të kënaqeshme	
Enët nuk janë të pastra	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Është zgjedhur programi i gabuar për larjen.</li> <li>• Enët janë vendosur në mënyrë të tillë që e pengojnë ujin të arrijë në të gjitha pjesët e sipërfaqes. Koshat nuk duhet të mbingarkohen.</li> <li>• Krahët spërkatës nuk rrotullohen lirisht për shkak të vendosjes së pasaktë të enëve.</li> <li>• Filtrat në bazamentin e dhomës së larjes janë të pisët ose të keq vendosur.</li> <li>• Është përdorur shumë pak ose aspak detergjent.</li> <li>• Në rastet kur në enë ka depozitime shtresash gëlqerore; mbajtësja e kripës është bosh ose është vendosur një nivel i pasaktë i zbutësit të ujit.</li> <li>• Lidhja e tubit të kullimit nuk është e saktë.</li> <li>• Kapaku i mbajtëses së kripës nuk është mbyllur mirë.</li> </ul>
Enët janë të njoma dhe të turbullta	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk është përdorur shpëlarës.</li> <li>• Foleja e shpëlarësit është bosh.</li> </ul>
Në gota dhe enë ka rrëqe, njolla të bardha ose veshje turbullire	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pakësoni sasinë e përdorur të shpëlarësit.</li> </ul>
Pikat e ujit janë tharë mbi gota dhe enë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtoni sasinë e përdorur të shpëlarësit.</li> <li>• Shkak për këtë mund të jetë detergjenti. Kontaktoni kujdesin e klientit të prodhuesit të detergjentit.</li> </ul>

Nëse, pas gjithë këtyre kontrolleve, problemi vazhdon, kontaktoni Qendrën lokale të Shërbimit.

## Të dhëna teknike

Përmasat	Gjerësia - lartësia - thellësia (cm)	59,6 x 81,8-89,8 x 55,5
Lidhja elektrike - Voltazhi - Fuqia e përgjithshme - Siguresa	Të dhënat mbi lidhjen elektrike janë dhënë në pllakëzën e parametrave që ndodhet në pjesën e brendshme të derës së enëlarëses	
Presioni i furnizimit me ujë	Minimumi - Maksimumi (MPa)	0,05 - 0,8
Kapaciteti	Përzgjedhjet e vendit	12
Pesha maksimale	kg	38

# Udhëzime për instalimin

## Instalimi



### PARALAJMËRIM

Çdo ndërhyrje elektrike dhe/ose hidraulike e nevojshme për instalimin e kësaj pajisjeje, duhet kryer nga një elektrikist dhe/ose hidraulik i kualifikuar ose nga një person i aftë.

Hiqni gjithë paketimet përpara se të poziciononi pajisjen.

Nëse është e mundur, pozicionojeni pajisjen ngjitur me një rubinet uji dhe kullimi.

Kjo enëlarëse është prodhuar për t'u ndërfutur në dollapët apo planet e punës së kuzhinës. Kujdes! Ndiqni me kujdes udhëzimet që gjeni në shembullin e bashkëngjitur për montimin e enëlarëses dhe ndërfutjen në mobilie.

Nuk janë të nevojshme zgavra shtesë për ajrosjen e enëlarëses, por vetëm për të bërë të mundur kalimin e tubit të kullimit dhe kabllos së ushqimit elektrik.

Enëlarësja ka këmbëza të rregullueshme për të mundësuar rregullimin e lartësisë.

Gjatë gjithë proceseve që kryhen në pjesët e brendshme të enëlarëses, ajo duhet hequr nga priza.

Kur fusni pajisjen në vend, sigurohuni që tubi i hyrjes së ujit, tubi i kullimit dhe kablo i ushqimit elektrik të mos jenë të përdhyer apo të shkelur.

## Mbështetja e sigurt në njësitë ngjitur

Enëlarësja duhet të mbështetet mirë duke mos u anuar.

Për këtë arsye, sigurohuni që mobilja nën të cilën enëlarësja është vendosur, është e siguar mirë në një strukturë të fiksuar (dollapë kuzhine, bufe, mur).

## Nivelimi

Nivelimi i mirë është thelbësor për mbylljen dhe puthitjen e mirë të derës. Kur pajisja është e niveluar në mënyrë të saktë, dera nuk prek asnjërin nga anët e dollapit anësor. Nëse dera nuk mbyllet në mënyrë të saktë, lironi ose shtrëngoni këmbëzat e rregullueshme derisa pajisja të jetë në nivel.

## Lidhja e ujit

### Lidhjet e furnizimit me ujë

Kjo pajisje mund të lidhet me një burim uji të nxehtë (maksimumi 60°) ose të ftohtë.

Me një burim uji të nxehtë mund të kurseni në mënyrë të ndjeshme energji. Gjithsesi, kjo varet nga mënyra si prodhohet uji i nxehtë. (Ne ju këshillojmë burime alternative energjie që nuk dëmtojnë ambientin, si p.sh. panele diellore ose fotovoltaike dhe gjeneratorë energjie elektrike me erë).

Për ta kryer vetë këtë lidhje, dadoja bashkuese e futur në tubin e furnizimit me ujë të pajisjes, vidhohet në 3/4" e grykës së gazit ose në një rubinet të posaçëm si Press-block (Shtyp-bloko).

Presioni i ujit duhet të jetë brenda kufijve të dhënë në "Specifikimet Teknike". Autoritetet lokale të Ujësjellësit, mund t'ju informojnë mbi presionin mesatar të ujit në zonën tuaj.

Tubi i hyrjes së ujit nuk duhet të përdridhet, të shtyhet ose të ngatërrohet kur lidhet. Enëlarësja përmban tubat e furnizimit dhe kullimit, të cilat mund të vendosen majtas ose djathtas me ndihmën e dados mbërthyesë, për t'iu përshtatur instalimit.

**Dadoja mbërthyesë duhet të mbërthehet saktë për të shmangur rrjedhje uji.**

(Kujdes! JO çdo model enëlarësesh i ka tubat e furnizimit dhe kullimit të ujit të pajisura me dado mbërthyesë. Në këtë rast, kjo nuk është e mundur). Nëse pajisja është e lidhur me tuba të rinj ose me tuba që nuk janë përdorur për një kohë të gjatë, duhet të lëshoni nëpër to ujë të rrjedhshëm për pak minuta, përpara se të lidhni tubin e furnizimit me ujë.

**MOS përdorni tuba lidhës që janë përdorur më parë për një pajisje të vjetër.**



Kjo pajisje është pajisur me mekanizma sigurie që parandalojnë ujin e përdorur në pajisje të kthehet mbrapsht në sistemin e ujit të pijshëm. Kjo pajisje është në përputhje me rregullat e zbatueshme hidraulike.

## Tubi i hyrjes së ujit me valvulën e sigurisë


Pasi lidhni tubin e dyfishtë të hyrjes së ujit, valvula e sigurisë është ngjitur me rubinetin. Si rrjedhojë, tubi i hyrjes së ujit është nën presion vetëm gjatë kohës që hyn uji. Nëse tubi i hyrjes së ujit fillon të rrjedhë gjatë punës, valvula e sigurisë e ndërpret ujin e rrjedhshëm. Lutemi bëni kujdes kur instaloni tubin e hyrjes së ujit:

- Kablli elektrik për valvulën e sigurisë ndodhet në tubin e dyfishtë të hyrjes së ujit. Mos e zhytni në ujë tubin e hyrjes së ujit ose valvulën e sigurisë.
- Nëse tubi i hyrjes së ujit pse valvula e sigurisë është e dëmtuar, hiqeni nga priza menjëherë spinën kryesore.
- A tubi i hyrjes së ujit me valvulën e sigurisë duhet zëvendësuar vetëm nga një specialist ose nga Qendra e Shërbimit.



## PARALAJMËRIM

Paralajmërim! Voltazh i rrezikshëm.



## Lidhja e tubit të daljes së ujit

Gryka i tubit të kullimit mund të lidhet në mënyrat e mëposhtme:

1. Në rubinetin e daljes së lavapjatës, duke e siguruar mirë në pjesën e poshtme të planit të punës. Kjo do të parandalojë hyrjen e ujit të ndotur të lavapjatës në pajisje.
2. Në një gyp të qëndrueshëm me vrimë për ventilim, me një diametër minimal prej 4 cm.

Lidhja për kullimin e ujit të ndotur duhet të ketë një lartësi maksimale prej 60 cm e llogaritur nga bazamenti i enëlarëses.

Tubi i kullimit mund të vendoset duke parë në djathtë apo në të majtë të enëlarëses.


Siguroni që tubi të mos jetë i përkthyer apo i shtypur, pasi kjo mund të pengojë apo të ngadalësojë shkarkimin e ujit.

Tapa e lavapjatës nuk duhet të jetë vendosur, kur pajisja është duke kryer procesin e kullimit, pasi kjo mund të sjellë si pasojë kthimin e ujit të kulluar sërisht në pajisje.

Gjatësia e plotë e tubit të kullimit, duke përfshirë çdo zgjatim të mundshëm, nuk duhet të kapërcejë 4 metrat. Diametri i brendshëm i tubit zgjatues nuk duhet të jetë më i vogël se diametri i tubit standard.


Si diametri i brendshëm i dadove bashkuese të përdorura për lidhjen me kullimin e ujit, nuk duhet të jetë më i vogël se diametri i tubit standard.

Kur lidhni tubin e kullimit me një rubinet nën lavapjatë, **e gjithë membrana plastike (A) duhet hequr**. Nëse nuk e hiqni gjithë membranën, kjo do të sjellë grumbullimin e mbetjeve të ushqimit me kalimin e kohës, duke bllokuar rubinetin e lidhur me tubin e kullimit të enëlarëses.



**i** Pajisjet tona janë të pajisura me një mekanizëm sigurie për të mbrojtur kundër kthimit të ujit të papastër mbrapsht në pajisje. Nëse rubineti i lavapjatës nuk ka një "valvul mos-kthimi" të ndërfutur, kjo mund të pengojë kullimin e saktë të ujit nga enëlarësja. Për këtë arsye, ju këshillojmë ta hiqni atë.

**i** Për të shmangur rrjedhje të ujit pas instalimit, sigurohuni që dadot bashkuese të ujit të jenë shtrënguar fort.



## Lidhja elektrike



### PARALAJMËRIM

Sipas standardeve të sigurisë, pajisja ka nevojë për tokëzim.

Përpara përdorimit të pajisjes për herë të parë, sigurohuni se parametrat e voltazhit dhe llojit të rrymës të shënuara në pllakën e parametrave janë në përputhje me parametrat e vendit ku do të instaloni pajisjen.

Parametrat e siguresës gjithashtu i gjeni në pllakën e parametrave.

Vendosni gjithmonë spinën kryesore në një prizë të instaluar mirë kundra dridhjes. Nuk duhen përdorur spinat me shumë hyrje dhe kabllot zgjatuese.

Kjo mund të shkaktojë zjarr si pasojë e mbinxehjes.

Nëse është nevojshme, ndryshojeni instalimet elektrike të spinës së shtëpisë tuaj. Në rast se kabli i ushqimit duhet të zëvendësohet, lutemi kontaktoni Qendrën lokale të Shërbimit. Spina duhet të jetë e arritshme pasi pajisja të jetë instaluar.

Mos u shkëpusni kurrë pajisjen nga rrjeti elektrik duke e tërhequr spinën nga kabli. Tërhiqeni gjithmonë nga spina.

Prodhuesi nuk mban përgjegjësi për defektet që vijnë si pasojë e mungesës së vëmendjes ndaj udhëzimeve të mësipërme të sigurisë.

## Probleme që lidhen me mjedisin

### Materialet paketuese

Materialet paketuese janë të padëmshme për ambientin dhe mund të riciklohen. Elementët plastikë identifikohen nga shenjat, si p.sh. >PE, >PS, etj. Lutemi hiqini gjithë materialet e paketimit në koshin përkatës të plehrave të lagjes tuaj.



### PARALAJMËRIM

Kur pajisja nuk do të përdoret më:

- Shkëputeni spinën nga priza.
- Priteni kabllon dhe spinën dhe hidhni ato.
- Çmontoni dhe hidhni kapësen e derës. Kjo parandalon rrezikun e kyçjes së fëmijëve brenda në pajisje duke rrezikuar jetën e tyre.

Благодарим вас за то, что выбрали одно из наших высококачественных изделий.

Чтобы обеспечить оптимальную и бесперебойную работу прибора, внимательно прочитайте настоящее Руководство. Это позволит выполнять все операции наиболее правильным и эффективным образом. Для того чтобы в нужный момент всегда можно было свериться с настоящим Руководством, рекомендуем хранить его в надежном месте. Просим также передать его новому владельцу прибора в случае продажи или уступки.

Надеемся, что новый прибор доставит вам много радости.

## Содержание

<b>Руководство по эксплуатации</b>	<b>30</b>	<b>Использование моющих средств</b>	<b>43</b>
<b>Сведения по технике безопасности</b>	<b>30</b>	Внесение моющего средства	44
Правильная эксплуатация	30	<b>Функция Multitab</b>	<b>45</b>
Общие правила техники безопасности	31	Включение/выключение функции Multitab	45
Безопасность детей	31	<b>Программы мойки</b>	<b>47</b>
Установка	31	<b>Выбор и запуск программы мойки</b>	<b>48</b>
<b>Описание изделия</b>	<b>32</b>	<b>Разгрузка посудомоечной машины</b>	<b>49</b>
<b>Панель управления</b>	<b>33</b>	<b>Уход и чистка</b>	<b>49</b>
Режим настройки	34	Чистка фильтров	49
Звуковая сигнализация	34	Чистка разбрызгивателей	51
<b>Первое использование</b>	<b>35</b>	Чистка духового шкафа снаружи	51
<b>Установка смягчителя воды</b>	<b>35</b>	Чистка внутренних частей машины	51
Настройка вручную	36	Чистка продолжительные перерывы в эксплуатации	51
Настройка электронным путем	36	Предотвращение замерзания	51
<b>Использование соли для посудомоечных машин</b>	<b>37</b>	Транспортировка машины	51
<b>Использование ополаскивателя</b>	<b>37</b>	<b>Что делать, если ...</b>	<b>51</b>
Отрегулируйте дозировку ополаскивателя	38	<b>Технические данные</b>	<b>54</b>
<b>Ежедневное использование</b>	<b>39</b>	<b>Инструкции по установке</b>	<b>54</b>
<b>Загрузка столовых приборов и посуды</b>	<b>39</b>	<b>Установка</b>	<b>54</b>
Нижняя корзина	40	Крепление к стоящей рядом мебели	55
Корзинка для столовых приборов	41	Выравнивание	55
Верхняя корзина	42	<b>Подключение к водопроводу</b>	<b>55</b>
Регулирование высоты верхней корзины	43	Подключение воды	55

Наливной шланг с предохранительным клапаном	56	<b>Подключение к электросети</b>	<b>58</b>
Подсоединение сливного шланга	57	<b>Охрана окружающей среды</b>	<b>58</b>
		Упаковочные материалы	58

Право на изменения сохраняется

## Руководство по эксплуатации



### Сведения по технике безопасности



